



Datë: 19.11.2025

Numër Protokolli: 7423/2025

A.nr.1794/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1794/2025, të datës 14.10.2025, të parashtruar nga ankuesi I.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 19.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1794/2025, të datës 14.10.2025, të parashtruar nga ankuesi I.H.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi I.H (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 14.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos ekzekutimin e të ardhurave personale 50% të pagës nga data 11.04.2014 deri më datës 15.03.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të pashtuara nga palët në procedurë vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 14.10.2025, **sepse:**

Ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.01-112-250 të datës 19.11.2024, ka qenë i punësuar në pozitën *Inspektor i Ndërtimit, SHC-0080*, në kuadër të Komunës së Prishtinës, sipas Vendimit 01nr.118-87627 të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është pezulluar me 50% të pagës deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata, për shkak të ndjekjes penale për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special me Aktgjykimin PKR.nr.601/21 të datës 27.07.2023 të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore ankuesi ka ushtruar ankese pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin me numër APS.nr.52/23 të datës 05.02.2024 e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës Themelore dhe ka liruar nëpunësin në fjalë.

Kryetari i Komunës së Prishtinës përmes vendimit me numër 14-021/03-39966/24 të datës 21.03.2024 ka shfuqizuar vendimin lidhur me pezullimin parandalues duke e kthyer ankuesin në vendin e punës respektivisht në Komunën e Prishtinës me pozitën “*Inspektor i Shërbimeve Publike*” në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe duke ju njohur edhe e drejta e kompensimit të 50% të të ardhurave personale, ndërsa më datë 15.03.2024 i është lëshuar Akt Emërimi AE.Nr.01-112-250 për pozitën *Inspektor*.

Kryetari i Komunës së Prishtinës me Vendimin me numër 14-020/04-164090/24 të datës 12.12.2024, ka caktuar komisionin për vlerësimin e pagave dhe kontributeve për nëpunësit civil të kthyer në punë sipas aktgjykimeve të formës së prerë dhe vendimeve të KPMSHCK-së, ndërsa komisioni pas vlerësimit të pagave dhe kontributeve të nëpunësve civil ka konstatuar duke bërë vlerësimin e pagave dhe kontributeve në mesin e të cilëve është edhe ankuesit.

Tutje Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës ka marr vendimin me numër 14-118/02-51630/24 të datës 31.01.2025 për përfundimin e marrëdhënien se punës me rastin e pensionimit të ankuesit. Ndërsa me datë 12.03.2025, Komuna e Prishtinës, ka paraqitur kërkesë tek Thesari i Kosovës për procedimin e pagesave në mënyrë retroaktive në bazë të vendimeve gjyqësore dhe KPMSHCK-së për shtatë zyrtar mesin e tyre edhe ankuesin, mirëpo nuk është realizuar.

Ankuesi më datë 06.08.2025 dhe 19.09.2025, ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, duke kërkuar kompensimin e 50% të pagave për periudhën nga data 11.04.2014 deri më datë 15.03.2024, ndërsa Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, përmes Zyrtarit të Lartë i Personelit, më datë 18.09.2025 i është përgjigjur Menaxherit të Personelit, lidhur me kërkesën e ankuesit, duke e njoftuar se ka ndërmarr të gjitha veprimet për zbatim të vendimeve të gjykatave dhe KPMSHCK-së.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme ende nuk është bërë kompensimi sipas obligimeve që kanë dalur nga vendimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kthimin në vendin e punës, duke kërkuar kompensimin e pagave nga data 11.04.2014 deri më datë 15.03.2024.

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 06.02.2025 kishte statusin e nëpunësi civil, gjegjësisht ankuesi më datë 06.08.2025 dhe 19.09.2025 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit të kompensimin retroaktiv të pagës , ndërsa, më Vendimin Nr. 14-118/02-51630/24 të datës 31.01.2025 të Udhëheqësit së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, ankuesi është liruar nga shërbimi civil me fillim nga data 06.02.2025, pra, nga kjo datë ankuesi, ka humbur statusin e nëpunësit civil.

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor sipas nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke qenë se ankuesi më rastin e parashtrimi të ankesës se datës 14.10.2025, nuk ka pas statusin e nëpunësit aktiv civil, atëherë, mbi ekzistimin e kësaj rrethane ligjore Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.1794/2025.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, ashtu që, Kolegji i Këshillit lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palën ankuese që drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore.

Gjegjësisht, lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1794/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit I.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.